

Gjatë regjistrimit vutë në dukje se fëmija juaj ka tjetër origjinë apo gjuha e tij mëmë nuk është vetëm anglishtja. Një mësues intervistoi fëmijën për të parë nëse nevojitet një mbështetje shtesë në gjuhën angleze. Informacioni i mbledhur gjatë intervistës nxori në pah se fëmija juaj mund të kualifikohet për shërbimin ELL dhe mund të identifikohet si një ELL/MLL. Për të përcaktuar nevojën e fëmijës tuaj për një mbështetje të mëtejshme të gjuhës angleze, fëmija juaj do t'i nënshtrohet Testit të Identifikimit të Shtetit të Nju Jorkut për Nxënësit e Gjuhës Angleze (Test for English Language Learners - NYSITELL).

Qëllimi i NYSITELL-it është të vlerësojë nivelin e gjuhës angleze të nxënësit me tjetër origjinë apo që nuk kanë si gjuhë amtare anglishten. Pikët që fëmija juaj do të marrë në NYSITELL (Hyrja, Zhvillimi, Kalimi, Zgjerimi apo Zotërimi) do të përcaktojnë nëse ai apo ajo mund të përftojë shërbimet e ELL-së dhe do të vendosë nivelin e mbështetjes së gjuhës angleze. Rezultati gjithashtu do të ndihmojë mësuesit të hartojnë programin më të mirë për fëmijën tuaj duke u bazuar se sa i aftë është ai apo ajo dhe sa nevojë ka në dëgjim, të folur, të lexuar dhe shkrim të anglishtes.

NYSITELL-i u bëhet ELL-ve/MLL-ve të mundshëm vetëm pas regjistrimit në një sistem shkollor të Shtetit të Nju Jorkut.

NYSITELL-i përfshin pyetje me alternativa, pyetje me përgjigje të shkurtra dhe të gjata, pyetje me përgjigje orale gjatë dëgjimit, të folurit, të lexuarit dhe shkruarit.

Shkolla ku është regjistruar fëmija do t'i dërgojë me postë një letër lajmërimi për prindërit ku do të tregohet niveli dhe masa të tjera shtesë që duhet të ndërmarrë. Nëse fëmija juaj identifikohet si ELL/MLL, do t'ju kërkohet të jini i pranishëm në një seancë orientimi ku do të mësoni rreth programeve të ELL-së që janë të gatshme për fëmijën tuaj.

Në varësi të rezultatit të fëmijës, ai apo ajo mund të konsiderohet si ELL/MLL. Në tabelën e mëposhtme do të gjeni një përshkrim të niveleve të zotërimit:

--	--

Hyrja
(Fillimi)

Një student në nivelin e Hyrjes është shumë i varur në mbështetjen dhe strukturat për të

Hyrja (Fillimi)	360 minuta	540 minuta	1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare Minimumi dy lëndë me përmbajtje bilinguale
Zhvillimi (Mesatar i ulët)	360 minuta	360 minuta	1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare Minimumi dy lëndë me përmbajtje bilinguale
Kalimi (Mesatar)	180 minuta	180 minuta	1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare Minimumi një lëndë me përmbajtje bilinguale
Zgjerimi (I Avancuar)	180 minuta	180 minuta	1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare Minimumi një lëndë me përmbajtje bilinguale

Lexojini fëmijë në gjuhën e tij të origjinës/amtare dhe/apo në anglisht (studimet tregojnë se të lexuarit në gjuhën amtare ndihmon në mbështetjen e aftësisë së fëmijës për të lexuar dhe shkruar në Anglisht)

Tregojini përralla fëmijës në gjuhën tuaj të origjinës/amtare.

Shkoni në bibliotekën vendase dhe merrni hua libra me audio në gjuhën tuaj të origjinës/amtare apo në anglisht.

Sigurohuni të jeni i pranishëm gjatë takimeve me prindër të caktuar nga shkolla juaj.

Lini një takim individual me mësuesin e fëmijës tuaj për të mësuar mënyra specifike se si mund të ndihmoni fëmijën tuaj

që të ke të3()9(f)6(m)16(i)13(j)10(ë)16(s)18()0()21(p51 0 0 1 197.54 440.83 1 260.57 Tm{)JTJETBT1 0 0 1 135.26 260.57 Tm8(t)10(j

